



Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren

University "Ukshin Hoti" Prizren

Universiteti i Prizrenit Univerziteti Prizren Prizren Universiteti "UKSHIN HOTI" Shkencave të Jetës dhe Mjedisit	
Prizren, më datë 13.03.2024	
Zyra e pranimit	Nr. i protokollit
50+	01-63

FAKULTETI I SHKENCAVE TË JETËS DHE MJEDISIT
FACULTY OF LIFE AND ENVIRONMENTAL SCIENCES

Rruga e Shkronjave Nr. 1, 20000 Prizren -Kosovë; Tel:+383 (0) 29 232 140; Homepage: www.uni-prizren.com

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

Lënda: Kryerja e Praktikës Profesionale për Studentët e nivelit bachelor "Agrobiznes" dhe master "Menaxhim në agrobiznes" të Fakultetit të (më tej FSHJM të Universiteti "Ukshin Hoti" Prizren(më tej Universiteti)

NENI 1

Institucioni//Ndermarrja Eko Farm Sh.P.K
e përfaqesuar nga Z/Zj Shqipron Maloku me
detyrë Drejtor dhe Fakultetit të Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM)
përfaqesuar nga Prof. Asoc. Dr. Albana Milaimi, Dekane i këtij Fakulteti, lidhin me
vullnet të lirë këtë kontratë.

NENI 2

Institucioni//Ndërmarrja merr persiper:

- 1.Të presë, të asistojë teknikisht dhe të monitorojë për një semestër të vitit akademikstudentin/tët duke caktur një nga punonjesit e vet si udheheqës të tij. Udheheqësi të jetë një specialist me përvojë sa më të madhe të jetë e mundur dhe sa më afër profesionit të studentit dhe objektivave të praktikës.
- 2.Të krijojë sa të jetë e mundur kushte lehtësuese, si vendqëndrim të përkohshëm nënjë zyrë, transport brenda zonës së praktikës brenda mundësive duke shfrytëzuar udhëtimet e automjeteve të veta për qëllime pune.
- 3.Të vlerësojë me shkrim punën, angazhimin dhe efektivitetin e praktikës profesionale të studentit,duke u ndalur veçanërisht në përfitimet e realizuara prej tij dhe në sugjerimet për fakultetin me qëllim përmirësimin e praktikës së studentëve të tjerë në të ardhmen.

Vlerësimi i përcillet zyrtarisht fakultetit në fund të punës praktikës.

NENI 3

Gjatë kohës së punës praktikës studenti zbaton orarin dhe detyrat që i cakton udhëheqësi në përputhje me kërkesat e programit të praktikës dhe me përmbajtjen e kësaj kontrate.

NENI 4

Fakulteti i Shkencave të Jetës dhe Mjedisit (FSHJM) merr përsipër:

1. Të dërgojë studentin/tët e FSHJM në praktikë në afatin e caktuar.
2. Të mbajë lidhje dhe të komunikojë me ndërmarrjen për problemet eventuale dhe për ecurinë e praktikës.
3. Të kontrollojë herëpas here procesin e kryerjes së praktikës nga studenti me qëllim të dhënies së ndihmës dhe rritjen e efektivitetit të saj.
4. Të vlerësojë praktiken e kryer nga studentët në përfundim të saj.

NENI 5

Mosmarreveshjet eventuale midis palëve do të zgjidhen me bashkëbisedim ose konsensus të dyanshëm.

U lidh me datën 04.03.2024

Për Institucionin/ Ndërmarrjen

DREJTORI



Për Fakultetin e Shkencave të Jetës dhe Mjedisit

DEKANI

Prof. Asoc. Dr. Albana Milaimi